

## **Duhani dhe Kanceri I Mushkërive**

Sot duhanpirja konsiderohet si shkaku kryesor i kancerit të mushkërive, si për meshkujt ashtu edhe për femrat. Sipas studimeve, 9 nga 10 persona me kancer të mushkërive janë duhanpirës. Është përllogaritur se rreziku që ka një duhanpirës për të shfaqur kancer të mushkërive është 10-30 herë më i madh se rreziku i joduhaniqësve. Rreziku rritet me sasinë e cigareve që konsumohen brenda ditës dhe me kohëzgjatjen në vite.

Nga ana tjetër, edhe duhanpirja passive rrit shanset me 20-30% për të zhvilluar kancer të mushkërive.

### **Si ndikon duhanpirja në shfaqjen e kancerit?**

Më shumë se 40 lëndë kimike që shkaktojnë kancer ndodhen në tymin e cigareve. Duhani përmban substanca kancerogjene të cilat ndikojnë në materialin gjenetik të qelizave të ADN-së, material i cili është rregullator i funksionit të duhur të tyre. Dëmtimet e ADN-së shkaktojnë shumëfishim/përhapje të pakontrolluar të qelizave, dhe për pasojë shfaqet kanceri. Duhani dëmton sistemin imunitar dhe mekanizmat mbrojtës bien.

### **Pasi është shfaqur kanceri a ka më vlerë të lihet duhani?**

Studimet tregojnë se lënia e duhanit përmirëson reagimin e organizmit ndaj terapisë, si për kimioterapinë ashtu edhe për radioterapinë, si dhe redukton efektet anësore ndërkohë që plagët kirurgjike shërohen më lehtë. Gjithashtu, rreziku i rikthimit të kancerit dhe shfaqja e një forme kanceri tjetër në organizëm ulët.

Lënia e duhanit sigurisht është veprimi më i mirë që mund të bëhet për sa i përket parandalimit të kancerit. Nëse ju lini duhanin, në çdo lloj moshe, rreziku për shfaqjen e kancerit të mushkërive reduktohet vazhdimisht me kalimin e viteve. Dhjetë vjet pas lënies së duhanit, rreziku i prekjes nga kanceri i mushkërive përgjysmohet.

**Kurrë nuk është vonë!**